

VENDIM
Nr. 798, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 699, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS’ VJORË (SHTESA)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Paragrafi i fundit, i pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- ullishte, me sipërfaqe 6 536 (gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) m², me vlerë 1 176 264 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.”;

b) Në pikën 4, shuma “254 371 689 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekësh” zëvendësohet me “254 524 689 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e pesëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë” dhe shuma “234 237 718 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë” zëvendësohet me “234 390 718 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë”;

c) Numri rendor 1, i tabelës së shtuar me vendimin nr. 38, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet sipas të dhënave të tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr. rendor në VKM-në 38/2020	Pronari			Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Drufrutorë (ullishte) Vlera në lekë	Sip. totale (m²)	Sip. e shpronësimit						Vlera (lek/m²)	Vlera totale (lekë)	Adresa	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						Arë (m²)	Ullishte (m²)	Vresht (m²)	Kullotë (m²)	Pemëtores (m²)	Pyll (m²)				
1	Vero	Selim	Harapaj	2074	160/20	Ullishte	153,000	4200								153,000	Bashkia Vlorë	Konfirmuar nga ASHK Vlorë. Shpronësuar me VKM-në nr. 38, datë 22.1.2020, për 1520 m². Vlerësimi për pasurinë e llojit "ullishte", është bërë me procesverbal në bazë të udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000, "Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".